

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e Shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A.”

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Operatori i Blerjeve të Përqëndruara SH.A. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe me Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të vecantë.

Çështjet të Tjera

Drejtimi i Entitetit është përgjegjës edhe për të dhënat e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi në përputhje me nenet 17 & 19 të ligjit. Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar. Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj opinionin në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart si dhe të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është në mospërputhje materiale me pasqyrat

financiare apo me informacionin e marrë gjatë auditimit, ose nëse duhet të jetë keq interpretuar. Nga ne kërkohet që kur lexojmë raportin e ecurisë, nëse konstatojmë se ekziston një gabim material në të, t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë përgjegjës për qeverisjen.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është me i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetedijshme e gjithë informacionit, keq përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me, midis çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Mes çështjeve që ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë, nëse ka, ato çështje që kanë qënë më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe rrjedhimisht janë çështje kryesore auditimi. Ne i përshkruajmë keto çështje në raportin tonë të auditimit përveç rasteve kur ligjet apo rregulloret e ndalojnë paraqitjen publike të çështjes ose kur, në raste shumë të rralla, ne vendosim që një çështje nuk duhet komunikuar në raportin tonë të auditimit sepse ndikimi negativ që do kishte, do të tejkalonte mjaftueshëm përfitimet e interesit publik të këtij komunikimi.

“Public Accounting Service Union and Trust”sh.p.k.

Rr. “Themistokli Gërmenji” Pallati Ambasador I, Kati I-rë Tirana– Albania

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L21423032S

Auditues ligjor

Ilda Duhanxhiu



Klodiana Ngjeksi PF

Rr. Omer Nishani, Pallati. "Ndertuesi shpk" kati 3,
Tirana– Albania

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): M32007004R

Auditues ligjor

Klodiana Ngjeksi

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'K' followed by a cursive flourish.

KLODIANA NGJEÇI PF
AUDITUES LIGJOR
NUIS : M32007004R
TIRANË - ALBANIA

Tiranë, më 28 shkurt 2025